

# Gjyqtari i Gjykatës së Tiranës Petrit Çomo para vettingut

5 Gusht 2020 LAJME

Gjyqtari Petrit Çomo i Gjykatës së Tiranës aktualisht edhe drejtues i saj doli të mërkurën para vettingut, përballë trupës së komisionerëve që ka kryer procesin e vettingut për të. Treshja e komisionerëve është Brunilda Bektashi, Xhensila Pine dhe Olsi Komici.

Petrit Çomo e ka filluar karrierën në drejtësi në vitin 2000 dhe ka punuar gjatë gjithë kësaj kohe si gjyqtar dhe zv.kryetar i Gjykatës së Tiranës. Subjekti Como ka qenë edhe anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për një periudhë disa vjeçare.

Në skedën e pasurisë të publikuar nga mediat rezulton se Çomo ka paqartësi në deklarinimin e një pjese të ardhurave që lidhen me dhënien me qera të një pasurie të paluajtshme. Kryesisht raportet mediatike thonë se pjesën kryesore të të ardhurave të gjyqtarit e zënë pasuri të trashëguara, por ka paqartësi në lidhje me deklarinimin e tyre në deklaratat e pasurive të disa viteve me pare. Këto paqartësi pasurore u vunë re edhe tek raporti i Inspektoriatit të deklarimit të pasurive i cili i raportoi Komisionit të Kualifikimit se gjyqtari ka bërë deklarinim të rremë.

Pasuria është në nga kriteret që ka rrëzuar pjesën më të madhe të gjyqtarëve në Vetting, shpesh duke e bërë të panevojshëm kontrollin për dy kriteret e tjera, siç është figura dhe lidhjet e mundshme me botën e krimit.

Do t'i takojë KPK-së të vendosë për gjyqtarin, nëse ai do të jetë ose jo pjesë e sistemit të drejtësisë në të ardhmen.